




Aplikimet janë të hapura deri më 08.12. në orën 23:59

[Aplikoni tani](#) 

Përshëndetje nga ekipi Spark

Gëzohemi që je i/e interesuar të marrësh pjesë në projektin tonë që është krijuar për nxënësit e shkollave të mesme (prej 14-18 vjeç) që jetojnë në Bujanoc, Preshevë dhe në Novi Pazar.

Ky program trajnimi është pa pagesë ku do të mësoni nga profesionistë për një periudhë prej 10 të shtunave (nga dhjetori deri në mars), si të:

- krijoni kampanja mediatike për rrjete sociale dhe
- rreth zhvillimit dhe menaxhimit të projekteve

Dhe jo vetëm kaq. Ne do të mbështesim ekipet me idetë më të mira të projekteve që janë të rëndësishme për juve dhe komunitetin tuaj:

- duke financuar mini projektet tuaja
- përmes mbështetjes nga trajnerë-mentorë (nga prilli në qershor)

Gjithashtu, në qershor do të zgjedhim ekipet më të suksesshme që do të kenë mundësi të vizitojnë **Irlandën Veriore gjatë verës.**

Të gjithë pjesëmarrësit që e përfundojnë programin Spark do të marrin një çerifikatë.

Këshilli Britanik ka angazhuar trajnerë me përvojë nga të gjitha pjesët e Serbisë për t'ju udhëhequr gjatë këtij procesi.

Çdo të shtunë, nga ora 11.00 deri në orën 15.00 do të organizohen sesione për krijimin e kampanjave mediatike në rrjete sociale dhe për zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve.

Sesioni i parë do të mbahet të shtunën, më 14 dhjetor, nga ora 11.00.

Ju lutemi regjistrohuni deri të dielën, më 08 dhjetor. Mund të pranojmë gjithsej deri në **150** pjesëmarrës.

Në Formularin e regjistrimit në këtë [link](#) të pyesim pse je i/e interesuar të marrësh pjesë në këtë projekt - të sfidojmë që ta plotësosh formularin në gjuhën angleze, por mund ta plotësosh edhe në gjuhën amtare.

Shihemi së shpejti në Novi Pazar, Bujanoc apo në Preshevë!

LOKACIONET

Punëtoritë do të mbahen në këto lokacione:

Preshevë – OJQ Livrit

Bujanoc – Fakulteti Ekonomik nga Subotica, departamenti në Bujanoc

Novi Pazar – Qendra Kulturore Novi Pazar (Punëtoritë në Novi Pazar do të zhvillohen në gjuhën serbe)

INFORMACIONET E KONTAKTIT

Nëse keni pyetje shtesë, ju lutemi dërgoni email tek Mina Kokot në adresën mina.kokot@britishcouncil.org

Gjatë trajnimeve do të keni mbështetjen e Koordinatorëve tanë dhe të Personave të Autorizuar për Siguri:

Evgjenije Islami – për Bujanoc dhe Preshevë

Anica Dodic – për Bujanoc dhe Preshevë

Azra Hasanbegovic – për Novi Pazar

Ky projekt financohet nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

Aplikimet janë të hapura deri më 08.12. në orën 23:59

Aplikoni tani 